



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË

Nr. 490 Prot.

Tiranë, më 19.02 2026

Lënda: Deklaratë për cilësinë dhe kushtet e kontrollit të brendshëm për vitin 2025 në
Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë

ZONJËS SUZANA HOXHA

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Tiranë

E nderuar Zonja Sekretare e Përgjithshme,

Në zbatim të ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në fuqi, ju përcjellim Deklaratën mbi Cilësinë dhe Kushtet e Kontrollit të Brendshëm për vitin 2025, për Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë.

Fusha e përgjegjësisë

Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues/Titullarit të njësisë, unë jam përgjegjës për ngritjen, zbatimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e një sistemi të shëndoshë të kontrollit të brendshëm, i cili synon dhe mbështet arritjen e politikave, qëllimeve dhe objektivave të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

Ky sistem siguron përdorimin e ligjshëm, ekonomik, eficient dhe efektiv të fondeve publike, si dhe mbrojtjen e aktiveve të njësisë publike. Për administrimin e këtyre fondeve dhe aktiveve unë mbaj përgjegjësi personale, në përputhje me përgjegjësitë dhe kompetencat e përcaktuara në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.

Qëllimi i sistemit të kontrollit të brendshëm

Sistemi i kontrollit të brendshëm është ndërtuar me qëllim menaxhimin e rreziqeve në një nivel të arsyeshëm, me synim minimizimin e rreziqeve që mund të ndikojnë negativisht në arritjen e politikave, qëllimeve dhe objektivave të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë. Për rrjedhojë, sistemi ofron një nivel garancie të arsyeshme dhe jo garanci absolute për efektivitetin e veprimtarisë së institucionit.

Sistemi i kontrollit të brendshëm bazohet në një proces të vazhdueshëm, i cili synon identifikimin, analizimin dhe renditjen e rreziqeve sipas nivelit të prioritetit të tyre, në raport me realizimin e objektivave institucionale. Ky proces përfshin vlerësimin e probabilitetit të materializimit të rreziqeve dhe të ndikimit që ato mund të kenë në rast të realizimit, si dhe përcaktimin dhe zbatimin e masave për menaxhimin e tyre në mënyrë efektive, eficiente dhe ekonomike.

Sistemi i kontrollit të brendshëm, për vitin 2025, ka funksionuar në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive deri në momentin e miratimit të raportit vjetor të veprimtarisë dhe të pasqyrave financiare. Ky sistem është ngritur, zbatuar dhe monitoruar në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit në fuqi, si dhe me udhëzimet dhe aktet përkatëse të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë Përgjegjëse për Ekonominë.

Aftësia për të trajtuar riskun

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ka vendosur një proces të integruar dhe të qëndrueshëm për menaxhimin e riskut, i cili siguron identifikimin, analizimin, vlerësimin, trajtimin, monitorimin dhe komunikimin e risqeve kryesore që lidhen me përgjegjësitë e institucionit. Qëllimi i këtij procesi është minimizimi i ngjarjeve negative të paparashikuara dhe maksimizimi i mundësive për arritjen e objektivave të DPM.

Për vitin 2025, DPM ka:

- Hartuar dhe përditësuar Regjistrin e Riskut, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;
- Integruar menaxhimin e riskut si pjesë të kulturës institucionale, duke e përfshirë në planet dhe veprimtaritë e përditshme të punës;
- Siguruar që përgjegjësia për menaxhimin e riskut të jetë e qartë dhe të zbatohet nga çdo punonjës, nga niveli operativ deri në hierarkinë më të lartë drejtuese;
- Trajnuar stafin në identifikimin, regjistrimin dhe trajtimin e riskut, duke caktuar një kordinator të veçantë për hartimin dhe përditësimin e Regjistrit të Riskut;
- Organizuar trajnime të specializuara nga Përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit të Cilësisë për stafin e laboratorëve mbi risqet e brendshme dhe mënyrat për t’i eliminuar, si dhe ka dhënë udhëzime për praktikën e menaxhimit të riskut;
- Siguruar që personat përgjegjës për menaxhimin e riskut të kenë kualifikimet e nevojshme për identifikimin dhe vlerësimin e tij, duke kryer trajnime mbi metodikat e njohura të analizës dhe menaxhimit të riskut;
- Raportuar për çdo ngjarje, pozitive apo negative, për të nxjerrë mësim dhe për të përmirësuar vazhdimisht proceset.

Ky proces kontribuon në forcimin e kontrollit të brendshëm, mbrojtjen e fondeve dhe aktiveve publike dhe garanton një menaxhim të efektshëm, eficient dhe ekonomik të riskut në të gjitha nivelet e DPM.

Procesi i menaxhimit të riskut;

DPM ka identifikuar, analizuar, vlerësuar, trajtuar, monitoruar dhe komunikuar risqet kryesore që lidhen me përgjegjësitë e saj, me qëllim minimizimin e ngjarjeve negative të paparashikuara dhe maksimizimin e mundësive. Në këtë kuadër, DPM ka hartuar regjistrin e riskut për vitin 2025.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut në DPM është hartuar në përputhje me ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar. DPM konsideron se për të qenë efektiv, menaxhimi i riskut duhet të bëhet pjesë e kulturës organizative, i integruar në planet dhe veprimtaritë e përditshme të punës, dhe duhet të jetë përgjegjësi e çdo punonjësi, nga niveli më i ulët deri tek hierarkia më e lartë drejtuese.

Stafi i DPM trajnohet dhe pajiset me njohuritë e nevojshme për menaxhimin e riskut, në mënyrë që të përshtatet me përgjegjësitë e tij specifike. Personat përgjegjës për menaxhimin e riskut kanë kualifikimin e nevojshëm për identifikimin dhe vlerësimin e riskut dhe kryejnë trajnime për përdorimin e metodikave të pranura në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.

Stafi është i trajnuar mjaftueshëm për të identifikuar, regjistruar dhe trajtuar risqet. Për këtë, është emëruar një koordinator i cili harton dhe përditëson regjistrin e riskut. Përveç kësaj, Përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit të Cilësisë ka hartuar dhe realizuar trajnime për stafin e laboratorëve mbi risqet e brendshme dhe mënyrat për eliminimin e tyre.

Raportimi mbi ngjarjet, si pozitive ashtu dhe negative, bëhet rregullisht, duke mundësuar mësimin nga praktikat e mira dhe përmirësimin e vazhdueshëm të menaxhimit të riskut.

Risku dhe kuadri i kontrollit;

Menaxhimi i riskut institucional përbëhet nga tetë komponentë të ndërthurur ndërmjet njeri tjetrit. Ata rrjedhin nga mënyra se si menaxhimi drejton dhe se si këto elemente janë të integruar me procesin e menaxhimit. Këta elementë janë :

- Ambienti i kontrollit
- Vendosja e objektivave
- Identifikimi i risqeve
- Vlerësimi i risqeve
- Përgjigja/reagimi ndaj risqeve
- Veprimtaritë e kontrollit
- Informimi dhe komunikimi
- Monitorimi

Mënyrat kryesore të menaxhimit të riskut;

DPM ka përdorur identifikimin e vazhdueshëm të riskut i cili është i nevojshëm për të identifikuar risqe të reja që nuk kanë dalë më parë, ndryshimet në risqet ekzistuese ose risqe ekzistenca e të cilave nuk është më e përshtatshme për DPM.

Identifikimi i risqeve i referohet si eksperiencës së kaluar ashtu dhe të ardhmes. Referenca e të kaluarës është fokusuar në raportet vjetore, mangësitë dhe dështimet e së kaluarës dhe raportet e brendshme.

Misioni, vizioni dhe vlerat janë pjesa e rëndësishme e Strategjisë, të cilat mbështesin dhe tre objektivat strategjike të DPM për periudhën përkatëse si më poshtë;

Objektivi nr.1. Zgjerimi i njohjeve ndërkombëtare të DPM.

Objektivi nr.2. Realizimi i gjurmshmërisë së matjeve në nivel më të lartë ndërkombëtar.

Objektivi nr.3. Rritja e shkallës së mbrojtjes së konsumatorve

Rishikimi i efektivitetit;

Në cilësinë e NA/Titullarit të Njesisë Publike, jam përgjegjës për rishikimin e efektivitetit të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në njësinë që drejtoj.

Rishikimi i efektivitetit bëhet bazuar në:

- Informacionin e ofruar nga audituesit e brendshëm (për laboratorët);
- Vlerësimet e drejtuesve të strukturave të njësisë, të cilët janë përgjegjës për krijimin, mbajtjen dhe funksionimin e kuadrit të kontrollit të brendshëm në strukturat përkatëse;
- Vetë-vlerësimin e kryer nga strukturat mbi funksionimin e kontrolleve të brendshme;
- Komentet e audituesve të jashtëm, të shprehura në raportet e tyre.

Në bazë të këtyre rishikimeve, unë jam këshilluar nga GMS mbi pasojat e rezultateve të verifikimit dhe, si rrjedhim, është hartuar një plan veprimi për trajtimin e mangësive të konstatuara në sistem, duke siguruar përmirësimin e tij të vazhdueshëm dhe funksionimin efektiv të kontrollit të brendshëm.

Efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm;

Veprimtaritë e kontrollit kryhen në të gjithë DPM dhe për të gjitha nivelet dhe funksionet e saj, nëpërmjet kontrolleve parandaluese, të cilat kanë për qëllim minimizimin e mundësisë që një risk të materializohet. Këto kontrolle kufizojnë probabilitetin e ndodhjes së një rezultati të padëshiruar dhe sigurojnë që objektivat e njësisë të arrihen në mënyrë efektive.

Kontrollet parandaluese përfshijnë, ndër të tjera:

- Ndarjen e detyrave, për të shmangur konfliktet e interesit dhe për të rritur integritetin e procesit;
- Kufizimin e veprimeve për personat e autorizuar, ku vetëm stafi i trajnuar dhe i autorizuar mund të kryejë veprimtari të caktuara.

Në këtë kuadër, DPM ka hartuar Rregulloren e Brendshme “Per Administrimin, Manaxhimin Financiar dhe Kontrollin e brendshëm”, e cila përcakton qartë procedurat, përgjegjësitë dhe masat e nevojshme për zbatimin e kontrolleve parandaluese dhe sigurimin e një sistemi të qëndrueshëm të kontrollit të brendshëm.

Grupet dhe Mekanizmat për Menaxhimin dhe Kontrollin e Riskut në DPM

1- Grupi për Menaxhimin Strategjik dhe Koordinatorin e Riskut

Në DPM funksionon Grupi i Menaxhimit Strategjik, i cili mblidhet rast pas rasti, sipas nevojave, për të diskutuar çështje strategjike dhe për të koordinuar aktivitetet lidhur me menaxhimin e riskut. Përveç grupit, është emëruar edhe Koordinatorin e Riskut, përgjegjës për përpilimin dhe përditësimin e regjistrit të riskut, si dhe për monitorimin e masave të kontrollit të riskut në të gjithë njësinë.

2- Auditimi i Brendshëm

DPM nuk ka një strukturë të auditimit të brendshëm në nivel organizativ. Auditimi kryhet nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI), sipas planit të auditimeve të saj.

- 3- Mekanizma të tjerë garantues dhe vetëvlerësimi i kontrollit të brendshëm, përveç auditimeve formale, DPM përdor mekanizma të tjerë për të siguruar efektivitetin e kontrollit të brendshëm, përfshirë vetëvlerësimin e funksionimit të kontrolleve të brendshme nga drejtuesit e strukturave dhe stafi përgjegjës.

Politikat dhe procedurat për adresimin e riskut;

DPM ka adoptuar dhe ndjek politika dhe procedura të strukturuar për menaxhimin e riskut në fusha kyçe, si më poshtë:

- Kontrollat buxhetore dhe financiare. Përdorimi i buxheteve dhe limiteve të deleguara për disa kategori shpenzimesh, si dhe kontrolli i kontabilitetit nga menaxheri përgjegjës, siguron që të gjitha shpenzimet të jenë të aprovuara dhe të kontabilizuara saktë. Këto kontrolle kufizojnë mundësitë për mashtrim dhe ndihmojnë në zbulimin e tij, duke garantuar një menaxhim të rregullt financiar.
- Kontrolle për zbatimin e standardeve ndërkombëtare në laboratore. Sektori i Menaxhimit të Cilësisë në DPM monitoron dhe kontrollon laboratorët për të siguruar zbatimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e Metrologjisë, duke garantuar saktësi, besueshmëri dhe cilësi të matjeve dhe shërbimeve laboratorike.

Duke Ju falenderuar,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Alkida Llaka

